

[Këtu mund të gjeni listën e përhershme të renditjes së gjyqtarëve të gjykatave të Shkallës së parë dhe gjykatave të apelit në Republikën e Shqipërisë](#)

Programi i Transparencës

**Programi i Transparencës për
Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Regjistri për regjistrimin e
kërkesave për të drejtën e
informimit**

**Formulari tip "Kërkesë për
Informacion"**

Informacion per Kandidatet

Informacion për Publikun

Vendim Nr. 189, datë 28.03.2006

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 147, të Ligjit Nr. 8811, datë 17.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, të Ligjit Nr.9399, datë 12.05.2005, "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare", të Ligjit Nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9110, datë 24.07.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda", të Rregullores për Procedimin Disiplinor të Gjyqtarëve, në mbledhjen e tij, të datës 28.03.2006,

Këshilli i Lartë i Drejtësisë:

1. Shqyrtoi procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit Artan Gjermëni dhe pasi votoi propozimin e parë të bërë nga Ministri i Drejtësisë për "shkarkim nga detyra" ndaj këtij gjyqtari, e rrëzoi atë. Më pas shqyrtoi dhe votoi për masën disiplinore "transferim në një gjykatë tjetër", të propozuar nga Ministri i Drejtësisë dhe, pasi e rrëzoi edhe atë, mbylli shqyrtimin e këtij procedimi disiplinor.

2. Vazhdoi procedurën e verifikimit të mandatit të zotit Artan Gjermëni si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare e datës 06.12.2005, zgjedhshmërinë e të cilit në përputhje me ligjin e kishte verifikuar në mbledhjen e mëparshme dhe, pasi verifikoi pajtueshmërinë dhe ushtrimin në përputhje me ligjin të detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konstatoi se, zgjedhja e tij si anëtar i këtij Këshilli është bërë në përputhje me ligjin.
3. Filloi procedurën e verifikimit të mandatit zonzës Altina Xhoxhaj, si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare e datës 10.03.2006, dhe, pasi verifikoi zgjedhshmërinë, pajtueshmërinë dhe ushtrimin në përputhje me ligjin të detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konstatoi se, zgjedhja e saj si anëtare e këtij Këshilli është bërë në përputhje me ligjin.
4. Pasi shqyrtoi kandidaturat për katër vende vakante për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Tiranë, vendosi që:
 - a- Të transferojë si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Vlorë, Alaudin Malaj.
 - b- T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin si gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Tiranë të : zotit Zamir Poda, zonzës Shega Ligori dhe zotit Artur Kalaja.
5. Pasi shqyrtoi kandidaturat për dy vende vakante për gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi që :
 - a- Të transferojë si gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Shefkie Demiraj.
 - b- T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të zotit Ferdinand Elezi.
6. Pasi shqyrtoi kandidaturat për një vend vakant për gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e zotit Fran Prendi si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
7. Pasi shqyrtoi kërkesat për transferim të dy gjyqtarëve, Ema Gashi dhe Skerdilajd Konomi, përkatësisht gjyqtarë të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë dhe Fier, vendosi që :
 - a- Të transferojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, gjyqtaren e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Vlorë, Ema Gashi.
 - b- Të transferojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Skerdilajd Konomi.
8. Shqyrtoi propozimet e Ministrit të Drejtësisë për delegime të gjyqtarëve dhe vendosi të bëjë delegimet sipas propozimeve përkatëse.
9. Vendosi të shtyjë shqyrtimin e proçedimeve disiplinore ndaj gjyqtareve: Taulant Tafa, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Leonard Dingo, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar dhe Leftar Jahaj, i Gjykatës së Apelit Tiranë, për në datën 14.04.2006, ora 11.00.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

[Kthehu në krye](#)